

Член 42

Во членот 259 став (1) точка 1 по зборот "договор" точката и запирката се бришат и се додаваат зборовите: "и за кое не поднел пријава за задолжително социјално осигурување".

Точката 2 се брише.

Точките 3, 4 и 5 стануваат точки 2, 3 и 4.

Во ставот (2) броевите: " 2, 3 и 5" се заменуваат со броевите: "2) и 4)", а бројот "4" се заменува со бројот "3)".

Член 43

Во членот 265 став (1) по точката 7 се додава нова точка 8, која гласи:

"8) за неспроведување на колективен договор (член 223 став (1));“.

Точката 8 станува точка 9.

Член 44

Во членот 266-г став (7) зборовите: "и државниот инспекторат за труд" се бришат.

ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 45

Синдикатите и здруженијата на работодавачи на повисоко ниво регистрирани пред денот на влегувањето во сила на овој закон се должни да се пререгистрираат во министерството надлежно за работите од областа на трудот, во согласност со овој закон, во рок од три месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 46

Комисијата се формира во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Барање за утврдување на репрезентативност, согласно со овој закон, синдикатите и здруженијата на работодавачи доставуваат во рок од 30 дена од денот на формирањето на Комисијата.

Член 47

Општите колективни договори се усогласуваат со одредбите од овој закон во рок од шест месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Колективните договори на ниво на гранка, односно оддел и колективните договори на ниво на работодавач се усогласуваат во рок од шест месеца од потпишувањето на општите колективни договори.

Член 48

Одредбите од колективните договори кои нема да се усогласат во рокот од членот 47 на овој закон престануваат да важат.

Член 49

Во целиот текст на Законот за работните односи по зборот "гранка", односно "гранки" во кој било род и број се додаваат зборовите: "односно оддел, согласно со Националната класификација на дејности".

Член 50

Се овластува Законодавно-правната комисија во Собранието на Република Македонија да утврди пречистен текст на Законот за работните односи.

Член 51

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 1

Në Ligjin për marrëdhëniet e punës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2005, 106/2008 dhe 161/2008), në nenin 5 paragrafi (1) pika 3, në fund të fjalisë lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 4 pika zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohen katër pika të reja 5, 6, 7 dhe 8, si vijojnë:

"5. "Orar pune" është çdo periudhë në të cilën punëtori punon dhe është në dispozicion të punëdhënësit, për kryerjen e punëve dhe të detyrave të punës në pajtim me ligjin;

6. "Kohë pushimi" është çdo periudhë e cila nuk është orar pune;

7. "Punë në turne" do të thotë çdo metodë e organizimit të punës në turne, në të cilën punëtorët ndërrohen njëri pas tjetrit në të njëjtin vend pune, në pajtim me një plan të caktuar dhe që mund të jetë i vazhdueshëm ose me ndërprerje, duke përfshirë nevojën që punëtorët të punojnë në kohë të ndryshme në periudhë të caktuar të ditëve ose javëve dhe

8. "Punëtor në turne" është çdo punëtor, orari i punës së të cilit është pjesë e punës në turne."

Neni 2

Në nenin 13 paragrafi (3) ndryshon, si vijon:

"(3) Punëdhënësi është i detyruar që të dorëzojë fletëparaqitje/fletëçregjistrim (Formulari M1/M2) për punëtorin në sigurimin e detyrueshëm social (pensional dhe invalidor, shëndetësor dhe sigurimin në rast papunësie), në pajtim me dispozitat e posaçme, në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, në formë elektronike ose drejtpërsëdrejti në Agjenci, para se të fillojë punëtorin me punë. Fotokopja e verifikuar e fletëparaqitjes i dorëzohet punëtorit në afat prej tri ditësh nga dita e hyrjes në punë."

Neni 3

Në nenin 23 në paragrafin (1) lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalës "ditë" shtohen fjalët: "dhe afati në të cilin punëdhënësi, pas skadimit të afatit për paraqitje do të bëjë zgjedhje, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe".

Neni 4

Në nenin 106 në paragrafin (3) pas fjalëve: "punë nate" shtohen fjalët: "punë kujdestarie, në pajtim me ligjin".

Neni 5

Në nenin 117 në paragrafin (2) fjala "dhjetë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për punëtorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët kryejnë detyra dhe autorizime të veçanta në pajtim me ligj të veçantë, puna jashtë orarit të punës mund të zgjasë më shumë se 190 orë në vit, për shkak të kryerjes së punëve urgjente dhe pa prolongim, me pajtimin me shkrim të punëtorit të dhënë paraprakisht."

Paragrafët (3), (4) dhe (5) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Neni 6

Titulli i nenit 118 ndryshon, si vijon: “Kujdestaria në shëndetësi”.

Neni 7

Në nenin 118 fjalët: “si punë jashtë orarit” shlyhen.

Neni 8

Pas nenit 122 shtohet titull i ri dhe nen i ri 122-a, si vijojnë:

“Orar pune i shkurtuar në kushte të veçanta

Neni 122-a

“(1) Punëtorit i cili punon në punë veçanërisht të rënda, të mundimshme dhe të dëmshme për shëndetin, ndërsa ndikimi i dëmshëm i të cilave mbi shëndetin e tij, përkatësisht aftësinë punuese në tërësi nuk mund të evitohet me masa mbrojtëse, orari i punës i shkurtrohet në përpjesëtim me ndikimin e dëmshëm mbi shëndetin e tij, përkatësisht mbi aftësinë punuese, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

(2) Gjatë realizimit të së drejtës për rrogë dhe të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, orari i shkurtuar i punës nga paragrafi (1) i këtij neni, barazohet me orarin e plotë të punës.

(3) Si punë veçanërisht të rënda, të mundimshme dhe të dëmshme për shëndetin konsiderohen: veçanërisht puna e rëndë fizike; puna nën presion të zmadhuar atmosferik; puna në zhurmë të madhe; puna në ujë ose lagështirë; puna e ekspozuar ndaj rrezatimeve jonizuese; puna me të sëmurë nga sëmundjet ngjitëse dhe me materiale infektuese; puna me intervenime kirurgjike në sallat e operacionit; puna në sferën e psikiatrisë; puna me persona me pengesa më të rënda në zhvillimin psikik; puna në mjekësinë gjyqësore dhe anatominë patologjike; puna me materiale brejtëse; puna me personelin e aviacionit; ekzekutimet e baletit; muziktarë të instrumenteve frymore; valltarë dhe solistë të operës; puna në afërsi të tensionit të ose nën tension dhe puna në lartësi ose në thellësi.

(4) Leje për punë me orar të shkurtuar pune nga paragrafi (3) i këtij neni, jep ministri kompetent për punët nga sfera e punës, në bazë të mendimit të marrë paraprakisht nga institucioni shëndetësor, i cili kryen veprimtari të mjekësisë së punës dhe mendim nga inspeksioni i punës.

(5) Kërkesë për ngritjen e procedurës për marrjen e lejes për punë me orar të shkurtuar pune, mund t'i parashtrijë punëtori ose organizata sindikale punëdhënësit.

(6) Institucioni shëndetësor i cili kryen veprimtari të mjekësisë së punës dhe inspeksion të punës, mendimin nga paragrafi (4) i këtij neni e dorëzon në bazë të elaboratit të përgatitur dhe të dorëzuar nga paraprakisht nga punëdhënësi.

(7) Kërkesë për marrjen e lejes për punë me orar të shkurtuar pune, punëdhënësi i paraqet ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës.

(8) Me kërkesën për marrjen e lejes nga paragrafi (4) i këtij neni, punëdhënësi dorëzon mendim nga institucioni shëndetësor, i cili kryen veprimtari të mjekësisë së punës dhe mendim nga inspeksioni i punës.

(9) Nëse inspeksioni i punës konstaton se ekzistojnë kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, me aktvendim do t'i urdhërojë punëdhënësit që të ngrejë procedurë për përcaktimin e orarit të shkurtuar të punës.

(10) Punëtori i cili punon në punët nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk guxon që të punojë në ato punë jashtë orarit të punës, as nuk mund të punësohet te punëdhënësi tjetër në punë të njëjta, për kohën për të cilën punon me orar të shkurtuar pune.”

Neni 9

Pas nenit 124 shtohet titull i ri dhe nen i ri 124-a, si vijon:

“Puna në turne

Neni 124-a

(1) Punëdhënësi mund ta organizojë punën edhe në turne.

(2) Punë në turne do të thotë çdo metodë e organizimit të punës në turne, në të cilën punëtorët ndërrohen njëri pas tjetrit në të njëjtin vend pune, në pajtim me planin e caktuar dhe i cili mund të jetë i vazhdueshëm ose me ndërprerje, duke e përfshirë nevojën që punëtorët të punojnë në kohë të ndryshme, në periudhë të caktuar të ditëve ose të javëve.

(3) Plani nga paragrafi (2) i këtij neni, i dorëzohet edhe organizatës sindikale te punëdhënësi, së paku dhjetë ditë pune para zbatimit të planit.”

Neni 10

Neni 127 ndryshon si vijon:

“(1) Punë nate konsiderohet puna në kohën e natës.

(2) Kohë nate është periudha ndërmjet orës 22,00 dhe orës 6,00 ditën e ardhshme.

(3) Punëdhënësi, i cili shfrytëzon rregullisht punëtorë për punë nate, obligohet që ta lajmërojë inspeksionin e punës.”

Neni 11

Në titullin e nenit 128 fjala “natën” zëvendësohet me fjalët: “kohë nate”.

Neni 12

Në nenin 128 në paragrafin (3) pas fjalës “Punëdhënësi” vihet presje dhe shtohen fjalët: “me shpenzimet e tij”, ndërsa “natën” zëvendësohet me fjalët: “kohë nate”.

Në pikën 4 pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “para angazhimit të tyre në punën e natës dhe në periudha të rregullta kohore të përcaktuara me ligj.”

Neni 13

Në titullin e nenit 129 fjala “natën” zëvendësohet me fjalët: “kohë nate”.

Neni 14

Në nenin 129 në paragrafin (1) fjalët: “natën deri në katër muaj” zëvendësohen me fjalët “kohë nate”, ndërsa pas fjalës “në ditë” zëvendësohet me fjalët “në çdo 24 orë”.

Neni 15

Në nenin 132 në paragrafin (1) fjalët: “me orar të plotë pune” zëvendësohen me fjalët “gjashtë orë dhe më shumë se gjashtë orë”.

Në paragrafin (4) fjalët “një orë” zëvendësohen me fjalët “dy orë”.

Neni 16

Titulli i nenit 133 ndryshon, si vijon: “Pushimi ditor”.

Neni 17

Në nenin 133 paragrafi (1) ndryshon, si vijon:
 “Punëtori ka të drejtë për pushim ditor së paku prej 12 orësh pa ndërprerje, gjatë 24 orëve.”
 Paragrafi (2) shlyhet.

Neni 18

Në nenin 134 në paragrafin (1) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “plus 12 orët e pushimit ditor nga neni 133 i këtij ligji.”

Neni 19

Në nenin 137 në paragrafin (1) pas numrit “20” shtohet fjala “pune”.

Neni 20

Në nenin 145 paragrafi (1) ndryshon si vijon:
 “Punëtori pas pushimit të marrëdhënies së punës në çfarëdo qoftë baze, ka të drejtë për dëmshpërbim për pushimin e pashfrytëzuar vjetor.”

Neni 21

Në nenin 182 në paragrafin (1) fjalët: “edhe një të cilin së bashku do ta caktojnë” shlyhen.

Neni 22

Në nenin 188 në paragrafin (2) pas fjalës “dispozicion” vihet presje dhe shtohen fjalët: “mënyra, kushtet dhe organet të cilat vendosin për ndarjen e pronës së sindikatës, përkatësisht shoqatës së punëdhënësve në rast të pushimit të veprimit”.

Neni 23

Neni 189 ndryshon, si vijon:
 “(1) Organizata sindikale në nivel të punëdhënësit e merr cilësinë e personit juridik, me ditën e regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.
 (2) Sindikata në nivel më të lartë, përkatësisht shoqata e punëdhënësve në nivel më të lartë e merr cilësinë e personit juridik, me ditën e regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, pas regjistrimit paraprak në regjistrin e sindikatave, përkatësisht në regjistrin e shoqatave të punëdhënësve.”

Neni 24

Në nenin 190 në paragrafin (1) para fjalës “Sindikatat” numri “1” zëvendësohet me numrin “(1)”, ndërsa pas fjalës “regjistrin” shtohen fjalët: “të sindikatave, përkatësisht regjistrin e shoqatave të punëdhënësve”.

Neni 25

Në nenin 191 paragrafi (1) ndryshon si vijon:
 “Regjistrimi në regjistër nga neni 190 paragrafi (1) i këtij ligji, kryhet në bazë të kërkesës së sindikatës në nivel më të lartë, përkatësisht të shoqatës së punëdhënësve në nivel më të lartë.”

Neni 26

Në nenin 192 në paragrafin (1) pas fjalës “sindikata” shtohen fjalët: “në nivel më të lartë”, dhe pas fjalës “aktvendim” pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “nga i cili një ekzemplar i dorëzohet Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë”.

Neni 27

Në nenin 194 paragrafi (3) pas fjalës “vepron” shtohen fjalët: “nën kushtet dhe”.
 Paragrafi (4) shlyhet.

Neni 28

Neni 201 ndryshon, si vijon:
 “Sindikata, përkatësisht shoqata e punëdhënësve pushon të veprojë nëse ashtu vendos trupi kompetent i sindikatës, përkatësisht shoqatës së punëdhënësve, e cila është e autorizuar me statut që të vendosë për pushimin e veprimtarisë së sindikatës, përkatësisht shoqatës.”

Neni 29

Në nenin 202 pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), si vijojnë:

“(6) Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, organi kompetent për mbajtjen e regjistrit, i shlyen organizatat nga regjistri.

(7) Një ekzemplar i aktgjykimit të plotfuqishëm nga paragrafi (5) i këtij neni, i dorëzohet edhe Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.”

Neni 30

Në nenin 204 para fjalës “Në nivel” shtohet numri “(1)”, ndërsa në pikën 1 fjala “ekonomia” zëvendësohet me fjalët: “sektori privat nga sfera e ekonomisë”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:
 “(2) Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik ka të bëjë me organet e pushtetit shtetëror dhe organet tjera shtetërore, organet e njësive të vetadministrimit lokal, institucionet, ndërmarrjet publike, entet, agjencitë, fondet dhe personat tjerë juridikë, të cilët kryejnë veprimtari me interes publik.”

Neni 31

Në nenin 205 paragrafi (1) ndryshon si vijon:
 “Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin privat nga sfera e ekonomisë, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe është e obligueshme për punëdhënësit dhe të punësuarit në sektorin privat.”

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:
 “(2) Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik, zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe është e obligueshme për punëdhënësin dhe të punësuarit në sektorin publik.”

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 32

Në titullin e nenit 211 pas fjalës “sindikata”, shtohen fjalët: “edhe të shoqatës së punëdhënësve”.

Neni 33

Neni 211 ndryshon si vijon:
 “(1) Përfaqësimi i sindikatës për territorin e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht i shoqatës së punëdhënësve për territorin e Republikës së Maqedonisë, përcaktohet për pjesëmarrje në trupat trepalëshe për partneritet social dhe delegacionet trepalëshe të partnerëve sociale.

(2) Përfaqësimi i sindikatës në nivel të sektorit publik, përcaktohet për shkak të pjesëmarrjes në marrëveshje kolektive në nivel të sektorit publik.

(3) Përfaqësimi i sindikatës, përkatësisht i shoqatës së punëdhënësve në nivel të sektorit privat nga sfera e ekonomisë, përcaktohet për shkak të pjesëmarrjes në marrëveshje kolektive në nivel të sektorit privat, nga sfera e ekonomisë.

(4) Përfaqësimi i sindikatës, përkatësisht shoqatës së punëdhënësve në nivel të degës, përkatësisht njësisë, përcaktohet për pjesëmarrje në marrëveshjen kolektive në nivel të degës, përkatësisht njësisë.

(5) Пërfaqësimi i sindikatës në nivel të punëdhënësit përcaktohet për shkak të pjesëmarrjes në marrëveshje kolektive në nivel të punëdhënësit.”

Neni 34

Neni 212 ndryshon si vijon:

“(1) Sindikata përfaqësuese për territorin e Republikës së Maqedonisë, është sindikatë e cila i plotëson kushtet në vijim:

1) të jetë e regjistruar në regjistrin e sindikatave të cilin e mban ministria kompetente për punët nga sfera e punës;

2) në të marrin pjesë së paku 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarave në Republikën e Maqedonisë, të cilët i paguajnë anëtarësi sindikatës;

3) të bashkojë së paku tri sindikata në nivel nacional nga degë të ndryshme, përkatësisht njësi të cilat janë regjistruar në regjistrin e sindikatave, i cili mbahet në ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës;

4) të veprojë në nivel nacional dhe të ketë anëtare të regjistruara së paku në 1/5 e komunave në Republikën e Maqedonisë,

5) të veprojë në pajtim me statutin e vet dhe principet demokratike dhe

6) në të të marrin pjesë sindikatat të cilat kanë nënshkruar, ose u janë qasur së paku tri marrëveshje kolektive në nivel të degës, përkatësisht njësisë.

(2) Sindikatë përfaqësuese në nivel të sektorit publik, është sindikata e cila është e regjistruar në regjistrin e sindikatave të cilin e mban ministria kompetente, për punët nga sfera e punës dhe në të cilën janë të anëtarësuar së paku 20% nga numri i të punësuarave në sektorin publik dhe të cilët paguajnë anëtarësi.

(3) Sindikatë përfaqësuese në nivel të sektorit privat nga sfera e ekonomisë, është sindikata e cila është e regjistruar në regjistrin të cilin e mban ministria kompetente për punët nga sfera e punës dhe në të cilën janë anëtarësuar së paku 20% nga numri i të punësuarave në sektorin privat, nga sfera e ekonomisë dhe të cilët paguajnë anëtarësim.

(4) Sindikatë përfaqësuese në nivel të degës, përkatësisht njësisë është sindikata e cila është e regjistruar në regjistrin të cilin e mban ministria kompetente, për punët nga sfera e punës dhe në të cilën janë anëtarësuar së paku 20% nga numri i të punësuarave në degë, përkatësisht njësi dhe të cilët paguajnë anëtarësi.

(5) Sindikatë përfaqësuese në nivel të punëdhënësit, është sindikata në të cilën janë anëtarësuar së paku 20% nga numri i të punësuarave të punëdhënësi dhe të cilët paguajnë anëtarësi.”

Neni 35

Neni 213 ndryshohet si vijon:

“(1) Shoqatë përfaqësuese e punëdhënësve për territorin e Republikës së Maqedonisë, është shoqata e cila i plotëson kushtet në vijim:

1) të jetë e regjistruar në regjistrin e shoqatës së punëdhënësve, të cilin e mban ministria kompetente për punët nga sfera e punës;

2) në shoqatë të jenë të anëtarësuar së paku 5% nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve në sektorin privat nga sfera e ekonomisë në Republikën e Maqedonisë, ose punëdhënësit anëtarë të shoqatës të punësojnë së paku 5% nga numri i përgjithshëm të punësuar në sektorin privat në Republikën e Maqedonisë;

3) anëtarë të shoqatës të jenë punëdhënës së paku prej tri degësh, përkatësisht njësisish;

4) të ketë anëtarë të vet së paku në 1/5, nga komunat në Republikën e Maqedonisë;

5) të ketë lidhur ose t'u jetë qasur së paku tri marrëveshje kolektive në nivel të degës, përkatësisht njësisë dhe

6) të veprojë në pajtim me statutin e vet dhe principet demokratike.

(2) Shoqatë përfaqësuese e punëdhënësve në nivel të sektorit privat nga sfera e ekonomisë, është shoqata e cila është e regjistruar në regjistrin të cilin e mban ministria kompetente, për punët nga sfera e punës dhe në të cilën janë të anëtarësuar së paku 10% nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve në sektorin privat, ose anëtarët punëdhënës të shoqatës të punësojnë së paku 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat.

(3) Shoqatë përfaqësuese e punëdhënësve në nivel të degës, përkatësisht njësisë, është shoqata e cila është e regjistruar në regjistrin të cilin e mban ministria kompetente, për punët nga sfera e punës dhe në të cilën janë të anëtarësuar së paku 10% nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve në degën, përkatësisht njësinë ose punëdhënësit anëtarë të shoqatës të punësojnë së paku 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në degën, përkatësisht njësinë.”

Neni 36

Pas nenit 213 shtohen gjashtë tituj të rinj dhe gjashtë nene të reja, 213-a, 213-b, 213-v, 213-g, 213-d dhe 213-gj, si vijojnë:

“Organi kompetent për përcaktimin e përfaqësimit

Neni 213-a

Përfaqësimin e sindikatës, përkatësisht të shoqatës së punëdhënësve në nivel të Republikës së Maqedonisë, në nivel të sektorit publik, në nivel të sektorit privat nga sfera e ekonomisë dhe në nivel të degës, përkatësisht njësisë në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarive, e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës, me propozimin e Komisionit për përcaktimin e përfaqësimit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), në pajtim me këtë ligj.

Përbërja dhe mënyra e punës së Komisionit

Neni 213-b

(1) Komisioni është i përbërë prej nëntë anëtarëve, nga të cilët nga tre përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë.

(2) Sindikatat dhe shoqatat e regjistruara të punëdhënësve në nivel nacional, mund të caktojnë përfaqësues të vetin, i cili do të marrë pjesë gjatë punës së Komisionit.

(3) Përfaqësuesit e ministrive nga paragrafi (1) i këtij neni, i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit të Punës dhe Politikës Sociale.

(4) Punët administrative-profesionale për punën e Komisionit, i kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(5) Mënyra e punës së Komisionit, përcaktohet me Rregullore për punë të Komisionit.

Kërkesa për përcaktimin e përfaqësimit

Neni 213-v

(1) Kërkesën për përcaktimin e përfaqësimit, Komisionit ia dorëzon sindikata, përkatësisht shoqata e punëdhënësve në nivel më të lartë.

(2) Me kërkesën dorëzohet edhe dëshmi për plotësimin e kushteve për përfaqësim, dhe atë:

1) aktvendimi nga regjistrimi në regjistrin e sindikatave, përkatësisht aktvendimi nga regjistrimi i shoqatave të punëdhënësve;

2) lista e anëtarëve të sindikatës të cilët paguajnë anëtarësi të verifikuar nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të sindikatës dhe punëdhënësit dhe fletanëtarësimin e anëtarëve, përkatësisht dëshmi për anëtarësimin e punëdhënësve në shoqatën e punëdhënësve;

3) lista e marrëveshjeve të lidhura kolektive ose marrëveshje kolektive të cilëve u është qasur sindikata, përkatësisht shoqata e punëdhënësve;

4) lista e sindikatave-anëtare të sindikatës sipas degëve, përkatësisht njërive, përkatësisht lista e punëdhënësve anëtarë të degëve, përkatësisht njërive dhe

5) lista e sindikatave lokale-anëtare, përkatësisht punëdhënësit nëpër komuna me seli dhe adresa.

(3) Pas përfundimit të procedurës për përcaktimin e përfaqësimit, fletanëtarësimet nga paragrafi (2) i këtij neni, u kthehen sindikatave.

(4) Punëdhënësi është i obliguar që me kërkesën e sindikatës, të japë vërtetim me listën e anëtarëve të sindikatës të cilët janë të punësuar te ai dhe paguajnë anëtarësi.

Procedura për kërkesën

Neni 213-g

(1) Komisioni përcakton nëse kërkesa dhe dëshmitë e parashtruara, janë në pajtim me këtë ligj.

(2) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës, me propozimin e Komisionit, miraton aktvendim për përfaqësim.

(3) Për aktvendimin për përfaqësim nga paragrafi (2) i këtij neni, mund t'i parashtrohet ankesë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Rishqyrtimi i përfaqësimit

Neni 213-d

(1) Përfaqësimi përcaktohet për periudhën prej tre vjetësh, nga dita e miratimit të aktvendimit.

(2) Sindikata dhe shoqata e punëdhënësve mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtimin e përfaqësimit, pas skadimit të periudhës prej një viti nga dita e miratimit të aktvendimit për përcaktimin e përfaqësimit.

(3) Kërkesa për rishqyrtimin e përfaqësimit, e cila i parashtrohet Komisionit përmban: emrin e sindikatës ose të shoqatës së punëdhënësve, nivelin e themelimit, numrin e aktvendimit për regjistrim, shkaqet e kërkesës për rishqyrtimin e përfaqësimit dhe paraqitjen e dëshmimeve për të njëjtën.

(4) Komisioni ngrit procedurë për përcaktimin e përfaqësimit, në pajtim me nenin 213-g të këtij ligji.

Shpallja e aktvendimit

Neni 213-gj

Aktvendimi për përfaqësim, shpallet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë."

Neni 37

Në nenin 216 para fjalës "Të përgjithshëm" shtohet numri "(1)", pas fjalës "marrëveshje" shtohen fjalët: "për sektorin privat", ndërsa fjalët: "territori i Republikës së Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "sektori privat - nga sfera e ekonomisë".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Marrëveshjen e përgjithshme kolektive për sektorin publik, e lidh sindikata përfaqësuese në sektorin publik dhe ministri kompetent për punët nga sfera e punës, me autorizim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë."

Neni 38

Në titullin e nenit 217 dhe në nenin 217 fjala "veprimtari" zëvendësohet me fjalën "njësi", ndërsa fjala "veprimtarinë" zëvendësohet me fjalën "njësinë".

Neni 39

Në nenin 231 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Njoftimi për lidhjen e marrëveshjes kolektive në nivel të punëdhënësit dhe koha për të cilën është lidhur, i dorëzohet ministrisë kompetente për punët nga sfera e punës, në afat prej tetë ditësh nga lidhja e saj."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 40

Në nenin 246 në paragrafin (4) fjalët: "sindikata dhe shoqata e punëdhënësve" zëvendësohen me fjalët: "sindikatat përfaqësuese në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe shoqatat përfaqësuese të punëdhënësve në territorin e Republikës së Maqedonisë".

Neni 41

Në nenin 251 paragrafi (1) shlyhet, ndërsa paragrafi (2) bëhet paragraf (1).

Neni 42

Në nenin 259 në paragrafin (1) në pikën 1 pas fjalës "marrëveshje" pikëpresja shlyhet dhe shtohen fjalët "dhe për të cilën nuk ka parashtruar fletëparaqitje për sigurimin e obligueshëm social".

Pika 2 shlyhet.

Pikat 3, 4 dhe 5 bëhen pika 2, 3 dhe 4.

Në paragrafin (2) numrat: "2, 3 dhe 5", zëvendësohen me numrat: "2) dhe 4)", ndërsa numri "4" zëvendësohet me numrin "3)".

Neni 43

Në nenin 265 në paragrafin (1) pas pikës 7 shtohet pikë e re 8, si vijon:

"8) për moszbatimin e marrëveshjes kolektive (neni 223 paragrafi (1));"

Pika 8 bëhet pikë 9.

Neni 44

Në nenin 266-g paragrafi (7) fjalët: "dhe inspektorati shtetëror për punë" shlyhen.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 45

Sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve të regjistruara në nivel më të lartë para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, obligohen që të reregistrohen në ministrinë kompetente për punët nga sfera e punës, në pajtim me këtë ligj, në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 46

Komisioni formohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kërkesën për përcaktimin e përfaqësimit, në pajtim me këtë ligj, sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve, e dorëzojnë në afat prej 30 ditësh nga dita e formimit të Komisionit.

Neni 47

Marrëveshjet e përgjithshme kolektive, harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Marrëveshjet kolektive në nivel të degës, përkatësisht njësisë dhe marrëveshjet kolektive në nivel të punëdhënësit, harmonizohen në afat prej gjashtë muajsh nga nënshkrimi i marrëveshjeve të përgjithshme kolektive.

Neni 48

Dispozitat nga marrëveshjet kolektive të cilat nuk do të harmonizohen në afatin e nenit 47 të këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 49

Në tërë tekstin e Ligjit për marrëdhëniet e punës pas fjalës “degë”, përkatësisht “degët” në cilëndo gjini dhe numër shtohen fjalët “përkatësisht njësi, në pajtim me Klasifikimin nacional të veprimtarive”.

Neni 50

Autorizohet Komisioni Juridiko-ligjvënës në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Neni 51

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

2522.

Vrz основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ГРАДЕЊЕ

Се прогласува Законот за градење, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 28 октомври 2009 година.

Бр. 07-4518/1 Претседател
28 октомври 2009 година на Република Македонија,
Скопје **Горге Иванов, с.р.**

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗА К О Н ЗА ГРАДЕЊЕ

I. ОПШТИ ОДРЕДБИ

Член 1

Со овој закон се уредуваат градењето, основните барања на градбата, потребната проектна документација за добивање на одобрение за градење, правата и обврските на учесниците во изградбата, начинот на употреба и одржување на градбата, како и други прашања од значење за градењето.

Член 2

Одделни изрази употребени во овој закон го имаат следново значење:

1. Градење е изведување на претходни работи, изработка на проектна документација, вршење на подготвителни работи, изградба на нова градба, доградба и надградба на постојна градба, реконструкција и адаптација на постојната градба што опфаќа земјени работи, изведување на градежна конструкција, вршење на градежно-инсталатерски работи и градежно-завршни работи, вградување постројки или опрема и други работи со кои се оформува целината на градбата;

2. Градба е се што настанало со изградба и е поврзано со земјиштето, а претставува физичка, техничко-технолошка и градежна целина заедно со изградените инсталации, односно опрема;

3. Времен објект е монтажно-демонтиран или типски објект кој се поставува на градежно неизградено земјиште, заради привремена употреба на просторот, до реализацијата на урбанистички план за градежното земјиште на кое е поставен временниот објект. Времен објект се поставува заради вршење на:

- сообраќајни дејности (привремени паркинзи и природни патеки),

- туристички, културни, спортско-рекреативни и забавни дејности (информативни паноа, платформи за спортски, културни, туристички и забавни настани, придружни објекти во функција на спортски настани и летни дискотеки) и

- објекти кои се во функција на граничните премини;

4. Урбана опрема претставува опрема која се поставува на градежно изградено земјиште. Под урбана опрема, во смисла на овој закон, се смета опрема за продажба на билети за јавен превоз, весници, сувенири, цвеќиња, сладолед, телефонски говорници, автобуски постројки, типски објекти за обезбедување кои се во функција на дипломатско-конзуларните претставништва, на објекти на органите на државната управа и на резиденцијалните објекти, јавни санитарни јазли, тераси со или без настрешници, платформи за јавни манифестации на копно и на водна површина, покриени и непокриени шанкови, самостојни рекламни паноа, детски игралишта, фонтани, чешми, клупи и корпи за отпадоци;

5. Реконструкција е изведување на работи во рамките на постојниот габарит на објект со кои се влијае врз исполнувањето на основните барања за градбата и со кои се менува усогласеноста на градбата со проектот според кој е изградена, со менување на фасада, промена на технолошкиот процес и на инсталацијата, санација и замена на конструктивни елементи и слично;

6. Адаптација е изведување на работи во внатрешноста на постоен објект со кои не се менуваат конструктивните елементи на градбата;

7. Надградба е изведување на работи на постоен објект со кои се влијае на основните елементи според кои е изграден објектот, а посебно на конструкцијата во висина, со изградба на нови етажи до максимално дозволената висина со урбанистичкиот план при што може да се влијае на конструктивниот систем во рамките на постојните габарити на основата;

8. Доградба е изведување на работи на постоен објект со изградба на нова површина надвор од габаритот на постојниот објект, до максимално дозволената површина предвидена со урбанистичкиот план, при што може да се влијае на конструктивниот систем на постојниот објект;